Subjekti ku mund të bëhet ankesa

1. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Bazuar në nenin 24 dhe nenin 33 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, si dhe nenin 21 të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ankesa mund të paraqitet pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në rastet e:

- mosrespektimit të procedurave të konsultimit publik;
- mungesës së transparencës;
- mosdhënies së informacionit publik;
- mosshqyrtimit të komenteve dhe rekomandimeve.

Të dhënat e institucionit: Rr. “Abdi Toptani”, Nd. 5, Kodi Postar 1001, Tiranë; tel. +355 42 237 200; e-mail info@idp.al; faks +355 42 233 977; numri i gjelbër 0800 2050.

2. Struktura përgjegjëse për transparencën dhe konsultimin publik në Bashkinë Pustec

Ankesa administrative mund të paraqitet edhe pranë strukturës përgjegjëse për transparencën dhe konsultimin publik në Bashkinë Pustec, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” dhe nenin 10 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të cilat përcaktojnë caktimin e koordinatorëve përgjegjës për konsultimin publik dhe të drejtën e informimit.

Institucioni: Bashkia Pustec. Adresa: Pustec, Korçë.